



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Aritech shpk” të datës 14.08.2026 kundër ftesës për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi (blerja) e pajisjeve të teknologjisë informative (kompjuterë, monitor dhe laptop Marrëveshjes publike kornize te AQP-se me nr. të ref. AQP;UA/2026-24-3927-1-1-1” me nr. të prokurimit 616-26-6616-5-5-8, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Aritech shpk” të datës 14.08.2026 kundër ftesës për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi (blerja) e pajisjeve të teknologjisë informative (kompjuterë, monitor dhe laptop Marrëveshjes publike kornize te AQP-se me nr. të ref. AQP;UA/2026-24-3927-1-1-1” me nr. të prokurimit 616-26-6616-5-5-8.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Aritech” (tutje “parashtruesi”) me datë 14.08.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër ftesës për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi (blerja) e pajisjeve të teknologjisë informative (kompjuterë, monitor dhe laptop Marrëveshjes publike kornize te AQP-se me nr. të ref. AQP;UA/2026-24-3927-1-1-1” me nr. të prokurimit 616-26-6616-5-5-8.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe

nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Autoriteti Kontraktues, në Ftesën për Ofertim për aktivitetin e prokurimit nr. 616-26-6616-5-5-8, ka përcaktuar vlerën e parashikuar të kontratës në shumën 324,000.00 EUR, duke e ndarë atë si vijon: • 4,000.00 EUR për vitin 2026; • 320,000.00 EUR për vitin 2027. Rrjedhimisht, 98.77% e vlerës së përgjithshme të kontratës është paraparë për vitin fiskal 2027. Ne konsiderojmë se kjo mënyrë e inicimit dhe strukturimit të aktivitetit të prokurimit nuk është dëshmuar se i përmbush kërkesat e nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, në veçanti kërkesat e paragrafit 3 të këtij neni lidhur me obligimet financiare që do të përmbushen nga ndarjet buxhetore të viteve të ardhshme fiskale".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi nuk ka parashtruar asnjë pretendim lidhur me kërkesat e DT apo ST/DT. Pretendimet e tij ndërlidhen me mënyrën e organizimit të buxhetit nga AK. Mirëpo kjo çështje monitorohet nga instancat tjera kompetente dhe nuk mund të jetë objekt i pretendimeve nga OE. Përtej kompetencës ekskluzive që e ka AK për organizimin e buxhetit, duhet cekur se në rastin konkret buxheti është organizuar mbi bazën e nevojave por edhe të mundësive që i ka AK. Nga të gjitha këndvështrimet, buxheti është alokuar dhe organizuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 21.08.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.